



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipal of Vitina

DATË/A	28.06.2022
REFERENCË	
PËR(ZA)TO	Publikimi i konkursit publik për mësimdhënës/se
CC:	
PËRMES (PREKO) THROUGH	Drejtorisë për Arsim të Komunës së Vitisë
NGA (OD) FROM	Njësia e Burimeve Njerëzore, Hysen Ymeri
TEMA (SUBJEKT) SUBJEKT	Konkurs publik në institucionet arsimore për Vitin shkollor 2022/23

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.06/L-114, neni 67, 68 dhe 69 të Ligjit për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, si Ligjit të Punës Nr.03/L-212, neni 8, paragrafi 1 dhe 2, Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Vitisë shpall:

K O N K U R S

në institucionet arsimore (IA) për vitin shkollor 2022/23

Nr.	Pozita	Statusi	Numri i pozitave
1	Edukatore	Me kohë të caktuar	3 (tri) pozita
2	Psikolog/e	Me kohë të pacaktuar	5 (pesë) pozita
3	Mësues/e, mbështetëse	Me kohë të caktuar	3 (tri) pozita
4	Mësues/e, klasor	Me kohë të caktuar	3 (tri) pozita
5	Mësimdhënës/e, Gjuhë shqipe	Me kohë të caktuar	3 (tri) pozita
6	Mësimdhënës/e, Matematikë	Me kohë të caktuar	1 (një) pozitë
7	Mësimdhënës/e, Fizikë	Me kohë të pacaktuar	2 (dy) pozita
8	Mësimdhënës/e, Fizikë	Me kohë të caktuar	1 (një) pozitë
9	Mësimdhënës/e, Gjuhë Angleze	Me kohë të caktuar	1 (një) pozitë
10	Mësimdhënës/e, Gjuhë Gjermane	Me kohë të caktuar	1 (një) pozitë
11	Mësimdhënës/e, Kulturë Muzikore	Me kohë të caktuar	1 (një) pozitë
12	Mësimdhënës/e, Histori dhe Edukatë Qytetare	Me kohë të caktuar	1 (një) pozitë
13	Mësimdhënës/e, Gjeografi	Me kohë të caktuar	1 (një) pozitë
14	Mësimdhënës/e, Gjeografi Edukatë Qytetare	Me kohë të caktuar	1 (një) pozitë
15	Mësimdhënës/e, Psikologji	Me kohë të caktuar	1 (një) pozitë

Ky konkurs publik vlen për të gjitha pozitat për mësimdhënës (personel) arsimor, për pozitat e lira të cilat janë dhe që paraqiten gjatë vitit shkollor 2022/23, me rastin e shkuarjes së personelit arsimor në pension, pushime mjekësore, pushime të lehonisë dhe në raste të tjera.

Kandidatët të cilët kanë aplikuar dhe përzgjidhen, radhiten në listë, në listën e pritjes sipas kualifikimit, rezultateve në intervistë, duke u bazuar në normativin në fuqi.

Të gjitha këto pozita të lira të shpallura janë për një vit shkollor, me përjashtim të pozitave zëvendësimit për pushim mjekësor dhe të lehonisë, deri në kthimin e punëtorit/es në vendin e tij/saj të punës.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit, i cili merret në Zyrën e Arkivit të Komunës;
- Diploma e fakultetit (çertifikatën e diplomimit jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj e fakultetit, e vërtetuar te noteri);
- Fotokopjen e letërnjoftimit;
- Vërtetimin e përvojës së punës;
- Vërtetimin nga gjykata se nuk është nën hetime;
- Të diplomuarit jashtë vendit, diplomat e tyre t'i nënshtrohen procesit të nostrifikimit nga MASHT-i.

Detyrat e Psikologut:

- Kryen dhe kujdeset për nxënësit (fëmijët) dhe mbi të gjitha promovon cilësinë me të cilin do të duhet të vijë ky shërbim;
- Merret me psikologjinë e nxënësve apo edhe të mësimdhënësit;
- Merret me mjedisin e shkollës, luan një rol të rëndësishëm në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm nga ana psikologjike, jo vetëm për nxënësit, por edhe për mësimdhënësit, ndaj mund të punojë si pjesë e një ekipi që përfshinë mësuesit dhe punonjësin social;
- Merret dhe ofron konsultime për të ndihmuar nxënësit në aspektin e sjelljes dhe mësimi. Këshillat dhe ofrimi i shërbimeve nga ana e psikologut shkollor duhet të bëhet në mënyrë të përshtatshme për nxënësit, sidomos në raste shumë të ndjeshme dhe specifike, duke respektuar kodin e etikës dhe deontologjisë;
- Ndihmon në krijimin e shkollave të sigurta dhe ambienteve pozitive, të cilat ndihmojnë në të mësuarit dhe sjelljen e nxënësve, merret kundrejt dhunës ndaj fëmijëve, përfshinë sjellje të ndryshme që mund të dëmtojnë dikë fizikisht dhe emocionalisht;
- Vepron kundër formave të bullizmi (ngacmimeve), kërcënime verbale, grindje fizike në çdo nivel dhe sulme me armë të ftohta. Përdorimi i lëndëve narkotike fatkeqësisht janë bërë pjesë e mjedisit shkollor dhe roli i psikologut shkollor në të tilla raste konsiston në ofrimin e këshillimit dhe mbështetjes emocionale tek nxënësit, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë;
- Psikologu i shkollës ndërhyr për të promovuar një mjedis mësimi që është i sigurt dhe gjithëpërfshirës. Psikologu i shkollës luan një rol në forcimin e partneriteteve mes prindërve, shkollave dhe gjithë komunitetit;
- Psikologu i shkollës pritet të shërbej si ndërlidhës midis familjeve dhe shkollës si dhe midis shkollës dhe komunitetit. Psikologu shkollor realizon gjetjen e vështirësive për të mësuar (strategjia e të mësuarit) programet për vetëbesimin, sigurinë, zhvillimet kreative, mësimet e teknikave sociale etj;
- Qëllimi tjetër është që të ndihmojnë nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit që të zhvillojnë potencialet e tyre dhe të kenë shëndet të mirë mendor. Psikologu njihet me dukuritë dhe rastet psikologjike, vëzhgon, përcjell, anketon, vlerëson, ndërhyr, këshillon, ofron shembuj të ndryshëm dhe propozon alternativa;

- Misioni i psikologut është lehtësues i nxënësit në procesin e të mësuarit, kalimin e gjendjeve dhe situatave psikoemocinale, në ndihmën për tejkalimin e frikës, ankthit dhe pasigurisë tek nxënësit në situata e momente të caktuara. Psikologu shkollor fokusohet në promovimin dhe zhvillimin mendor e fizik të nxënësve si dhe në ndihmesën dhe mbështetjen që jep për rritjen e cilësisë së procesit të mësimnxënies dhe mësimdhënies;
- Merret me zhvillimin mendor e fizik i nxënësve, rritja e cilësisë së procesit të mësimnxënies dhe mësimdhënies. Nuk do analizë nga fakti se këto janë “ekzistenca dhe jeta e një shkolle”. Psikologu i shkollës, këshillimin e realizon përmes mbledhjeve me anëtarët e stafit mësimdhënës të shkollës dhe komunitetit të prindërve për të identifikuar dhe parandaluar probleme të ndryshme, si dhe për të programuar ndërhyrje dhe shërbime të nevojshme;
- Bashkëpunon me personelin administrativ dhe pedagogjik të shkollës, shërbime këto që lidhen me vlerësimin e rezultateve të nxënësve, me orientimin e karrierës dhe me zhvillimin social dhe personal të nxënësve, nëpërmjet sigurimit të shërbimeve të drejtpërdrejta për fëmijët dhe nxënësit në nevojë;
- Bënë vlerësimin dhe interpretimin e rezultateve të nxënësve, të stafit pedagogjik të shkollës dhe të prindërve;
- Merret me shërbimet këshillimore dhe trajnuese për stafin e shkollës dhe prindërit;
- Merret me konceptimin dhe realizimin e shërbimit psikologjik në përputhje me politikat e zhvillimit të arsimit pasuniversitar dhe të institucionit arsimor.

Detyrat e mësimdhënësit

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizoj planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës, duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës dhe aktet tjera nënligjore;
- Të zbatojë detyrat e punës, duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin edukativo-arsimor;
- Të planifikoj, të udhëheq dhe të vëzhgojë nxënien dhe sjelljet e secilit nxënës;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurikulare;
- Të krijoj një atmosferë pune dhe discipline, pa përdorur metoda ndëshkimi ose forma të ndryshme të poshtërimit të nxënësve;
- Të kontrolloj me rregull dhe të mbaj evidencë për suksesin dhe programin individual të secilit nxënës, si dhe të jetë në gjendje t’i raportoj prindit apo kujdestarit të fëmijës drejtë për progresin e arritur të nxënësit sipas kërkesës;
- Të kujdeset për zhvillimin e vazhdueshëm profesional individual sipas planit të paraparë dhe të kujdeset për realizimin e planifikimit;
- Të jetë në komunikim të vazhdueshëm me familjen e nxënësit, duke realizuar takime individuale me prindër, kujdestar të fëmijës;
- Të ndihmoj kolegët në ngritjen e cilësisë së punës;
- Të marr pjesë në punën e organeve të shkollës;
- Të marrë pjesë aktive në përgatitjen e programeve dhe evenimenteve në shkollë, kur kërkohet nga drejtori i shkollës;
- Të respektoj autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit, të cilit organ i raporton dhe t’i kryej detyrat që mund t’i caktojë ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Të mos kërkojë apo pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër, përveç drejtorit të shkollës dhe DKA-së ose personave të caktuar nga ata;
- Të mos shfrytëzoj pozitën e punës për interesa private në dobi të një pale të tretë, përfshirë edhe familjen, shoqërinë apo rrethin shoqëror;

- Të ushtroj maturi maksimale lidhur me të gjitha çështjet e punës, përfshirë ruajtjen e informatave, nëse nuk janë publike, të cilat lidhen me procesin e punës dhe raporteve të krijuara prej saj, duke mos komunikuar këto informata me asnjë person fizik apo juridik, përveç kur informatat e tilla janë të parapara në kuadër të detyrave sipas kontratës apo autorizimit nga zyrtari të cilit i raporton;
- Të mbaj orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore;
- I punësuari është i obliguar të respektoj kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar me rregulloren e brendshme të shkollës dhe me aktet e tjera nënligjore;
- I punësuari sipas kontratës nuk do të kryej punë apo detyrë tjetër me orar të plotë nëse puna e tillë bie ndesh me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga DKA-ja ose përfaqësuesit e saj.

Kandidatët të cilët konkurrojnë në pozitat mësimdhënës, duhet të kenë përgatitjen përkatëse-profesionale, sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm.

Kandidatët e interesuar për aplikim, aplikacionet i marrin dhe i dorëzojnë në Arkivin e Komunës së Vitisë.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, sipas Ligjit për Zyrtar Publik

Afati i konkursit është 15 ditë nga data e publikimit në tabelën e shpalljeve, web faqen e Komunës, duke filluar nga data 28.07.2022 deri më 05.08.2022.

Kandidatët aplikantë të cilët kanë konkurruar, i njoftojmë se pas mbylljes së konkursit do t'i nënshtrohen intervistës me shkrim dhe gojë.

Viti, më 28.06.2022

Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore

